



Pranuar / Dorezuar Primi/Prodato Received/Delivery	29.05.2023	5	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	4497/2023		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.635/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.635/2023 të datës 13.04.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga " ", Komuna Ferizaj, kundër Vendimit me numër KD.nr.07/2023 i datës 10.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.635/2023 e datës 13.04.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër KD.nr.07/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesit i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 13.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me Numër Prot:635/2023,

kundër Vendimit me numër KD.nr.07/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore dhe zhvillimit të procedurës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues, ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material si dhe ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankuesit si të bazuar ndërsa të anulojë Vendimi e datës 10.03.2023 me numër KD.nr.07/2023 të Komisionit Disiplinor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 08.05.2023 ka pranua nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoli:2378/2023, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:3524/2023 të datës 13.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër KD.nr.07/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Raportin përfundimtar i hetimeve i datës 09.12.2023 me numër:1303; Vendimin e datës 20.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin e datës 20.12.2022 për nëpunësin A.K; Vendimin e datës 20.12.2022 për nëpunësin B.Z; Vendimin e datës 04.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin e datës 25.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.04.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 08.05.2023; Vendimin e Këshillit A.nr.478/2022; Vendimin e datës 13.03.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Flete kthesën e datës 13.03.2023; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 10.03.2023; Ftesën për intervistë e datës 23.02.2023; Procesverbalin e datës 28.02.2023; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 14.02.2023 me numër:183; Formularin e intervistimit të datës 08.11.2022 për ankuesin; Formularin e intervistimit të datës 08.11.2022 për nëpunësin F.H; Formularin e intervistimit të datës 08.11.2022 për nëpunësin M.SH; Formularin e intervistimit të datës 08.11.2022 për nëpunësin F.D; Formularin e intervistimit të datës 08.11.2022 për nëpunësin B.Z; Formularin e intervistimit të datës 08.11.2022 për nëpunësin A.K; Formularin e regjistrimit të vizitave për vitin 20.10.2022; Dosjen e hapur të datës 24.09.2022 për të burgosurin K.B.B; Dosjen e hapur të datës 17.08.2022 për të burgosurin B.B; Dosjen e hapur të datës 07.08.2022 për të burgosurin B.B; Dosjen e hapur të datës 20.07.2022 për të burgosurin F.N.C; Dosjen e hapur të datës 21.09.2022 për të burgosurin C.S.G; Dosjen e hapur të datës 29.09.2022 për të burgosurin M.I.B; Shkresën e datës 20.10.2022 të lëshuar nga F.D; Vendimin me shifër KD.nr.053/2022 e Komisionit Disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.635/2023 e datës 13.04.2023 e parashtruar nga ankuesi është e **bazuar**, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.066/2022 të datës 04.07.2022 ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën "Drejtor i Qendrës së Paraburgimit-Qendra e Paraburgimit Gjilan", ndërsa ndaj të njëjtit me datë 14.02.2023 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka iniciuar procedurën disiplinore me pretendimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Kryesuesi i Komisioni Disiplinor pas pranimit të kërkesës për iniciimin të procedurës disiplinore, përmes shkresës së datës 23.02.2023 e ka ftuar ankuesin në intervistën e planifikuar të datës 28.02.2023, mirëpo ankuesi këtë ftesë e kishte pranuar me datë 27.02.2023, një ditë përpara mbajtjes së seancës. Tutje, Komisioni Disiplinor me datë 10.03.2023 ka nxjerrë Vendimin KD.nr.07/2023 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ulje në pozitë" të përcaktuar me nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, me arsyetimin se i njëjti është përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 45 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 lidhur me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 58 paragrafi 3 pika 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: "Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë", nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe ligjeslicaionit të veçantë, gjegjësisht me ligj të veçantë ndryshe mundë të rregullohen ndryshe vetëm çështjet e përcaktuara sipas dispozitave të nenit 4 paragrafi 2 Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: " 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve", nga rrjedh zyrtarëve publik të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës e të cilët e kanë statusin e nëpunësit civil, nuk mund t'u shqiptohet ndonjë masë tjetër disiplinore përveç masave të përcaktuara me nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, sikurse janë përcaktuar: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", ngase për çështje të tilla Ligji Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë është ligj bazikë sikurse në rastin konkret, prandaj pretendimi ankimor i ankuesit se Komisioni Disiplinor ka zbatuar gabimisht dispozitat e legjislacionit në fuqi është pretendim i bazuar, ngase masa e disiplinore "Ulje në pozitë" e shqiptuar ndaj tij nuk është masë disiplinore e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me shkeljet esenciale të procedurës së zhvilluar ndaj tij nga ana e Komisionit Disiplinor, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 48 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate”* si dhe nenin 10 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë përcaktohet se: *“Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative”* nga rrjedh se në rastin konkret Komisioni Disiplinor ka shkelur në mënyrë flagrante dispozitat e lartcekura ligjore, ngase nga provat e ofruara nga Njësia për Menaxhimin Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës është konstatuar se ankuesi përmes shkresës së datës 23.02.2023 është ftuar në intervistën e planifikuar të datës 28.02.2023, mirëpo ankuesi këtë ftesë e kishte pranuar me datë 27.02.2023, pra vetëm një ditë përpara mbajtjes së seancës, kurse përmbajta e ftesës ka qenë, si vijon: *“Ju njoftojmë se jeni të ftuar në cilësinë e të dyshuarit pranë Komisionit Disiplinor në Drejtorinë Qendrore të SH.K.K për të dëshmuar lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore; .. Intervista do të mbahet me datë 28.02.2023 në ora 09:00 në Drejtorinë Qendrore në Prishtinë, Salla 621”*, nga rrjedh se ankuesi nuk është njoftuar paraprakisht nga Komisioni Disiplinor lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, i është mohuar e drejta për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar dhe madje i njëjti nuk është udhëzuar dhe as njoftuar përpara se t’i dërgohet ftesa për seancë, se i njëjti me rastin e paraqitje për intervistim apo seancë disiplinore mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nga rrjedh se këto veprime apo mosveprime të anëtareve të Komisionit Disiplinor janë veprime në kundërshtim edhe nenin 94 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes”*.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi shkresave të lëndës gjegjësisht procesverbalit të datës 28.02.2023 në të cilën ankuesi ka qenë i ftuar të dëshmojë në cilësi të të dyshuarit për shkelje të rënda disiplinore, sikurse edhe të procesverbalit të datës 10.03.2023 në të cilën seancë edhe është marrë vendimi për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit, ka gjetur se në përmbajta të Vendimit me numër KD.nr.07/2023 të datës 10.03.2023, theksohet fakti se Komisionit Disiplinor ka administruar këto prova, citoj: *“ për Inicimin e procedurës disiplinore nr.183 datë 14/02/2023 nga Zëvendësdrejtor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Vendimi i Komisionit Disiplinor nr.053 datë 13/12/2022 mbi pezullimin nga puna për . . . Vendimi nr.053 datë: 13/12/2023 mbi vazhdimin e afatit për Procedurën disiplinore, Raportin e kompletuar Hetimor me nr.043 datë; 16/01/2022, Raportin Përfundimtar i hetimeve me nr.1303 datë:09/12/2022, Vendimi mbi shqiptimin e masës disiplinore nr.053 datë:23/01/2023, Procesverbalet e seancës dëgjimore nga Komisioni Disiplinor datë:28/02/2023”* dhe po ashtu konstatohet fakti se Komisioni Disiplinor nuk e ka ftuar në seancë

edhe iniciuesin e procedurës disiplinore, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim kompetencat dhe obligimit ligjore që kanë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku shprehimisht rregullohet se: *“1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 3. Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklaratat nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t’u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes”* ngase sipas detyrës zyrtare ka qenë i obliguar të ftohet në seancë edhe iniciuesi i procedurës disiplinore, sikurse Komisioni Disiplinor nuk mundet t’ua fal besimin gjetjeve të Raportit përfundimtar me numër protokoli:1303 të datës 09.12.2022 i hartuar nga Komisioni Hetimor, pa dashur të prejjudikojmë në rastin konkret vërtetësinë e tyre, pasi që sipas detyrës zyrtare Komisioni Disiplinor është i obliguar të verifikoj apo të bëjë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura dhe të kryej çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes për të cilën është ngarkuar nëpunësi civil, ndërsa nga administrimi i provave sikurse u potencua më lartë në Vendimi me numër KD.nr.07/2023 të datës 10.03.2023 vërehet që provat relevante nuk janë shqyrtuar fare në procedurë, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit se Komisionin Disiplinor ka bërë shkelje procedurale gjatë shqyrtimit të procedurës disiplinore janë të bazuara, ndërsa Komisioni Disiplinor me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, gjegjësisht 48 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, në kundërshtim me nenin 11 dhe 12 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe dispozitat e lartë cekura të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Prandaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë paragrafin 1 të nenit 134 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të ankuesit lidhur me shkeljet procedurale nga ana e Komisionit Disiplinor sikurse edhe interpretimit të gabuar të ligjit material, gjegjësisht të shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit e cila masë nuk është e përcaktuar me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit për shkak të shkeljeve të konstatuara sikurse në arsyetimin e këtij vendimi ka ardhur në përfundimin, se nuk mund të përlij një akt administrativ, në rastin konkret Vendimin me numër KD.nr.07/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, akt ky i cili është nxjerrë nga një procedurë e përcjellë me shkelje flagrante të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj si rrjedhojë është konstatuar fakti se Vendimi me numër KD.nr.07/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor është akt administrativ i paligjshëm sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *“1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme,”* dhe si i tillë është vendimi i Komisionit Disiplinor është shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkak të konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.635/2023

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetari i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së